

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Newsletter

Shkurt 2021



Kush jemi?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) është një institucion i pavarur kushtetues, i ngritur në 1 Shkurt 2020. ILD është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.


Inspektor i Lartë i Drejtësisë është zgjedhur Z. Artur Metani, i cili e ushtron detyrën që prej datës 20.01.2020 bazuar në Vendimin nr. 2/2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë".

Kuadri ligjor

- ◇ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- ◇ Ligj nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- ◇ Ligj nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";
- ◇ Vendim i Këshillit të Ministrave për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit.

Përmbajtja

Kush jemi?.....	1
Ankimimi në ILD	2
Statistika Shkurt 2021.....	2
Inspektorët e rinj në ILD	3
Trajnim me Euralius.....	3
Trajnim me TAIEX.....	3
Intervistë për Vizion Plus.....	4
Memorandum bashkëpunimi	4
Intervistë për Euronews AL	5



Ankimimi në ILD

Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë ankesë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kur ka të dhëna të besueshme, se një magjistrat ka kryer shkelje disiplinore. Ankesa mund të bëhet online, duke plotësuar formularin në faqen tonë zyrtare; të dërgohet me postë; ose të depozitohet personalisht pranë ILD-së, nga e hëna në të premte nga ora 10.00 - 13.00, e ku në rast nevojë ofrohet asistencë nga punonjës të Sektorit të Ankesave.



“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

Sektori i ankesave

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

STATISTIKA

Gjatë muajit **Shkurt** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 88 ankesa të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.


Konkretisht:

80 ankesa janë depozituar nga qytetarët;

8 ankesa kanë ardhur nga institucione publike dhe jopublike.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Shkurt 2021.

Ankesat të cilat kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projekt-vendimet përkatëse.





TRAJNIM I INSEKTORËVE TË ILD MBI HETIMIN DISIPLINOR TË MAGJISTRATËVE




Në institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u zhvillua trajnimi një ditore me inspektorët e rinj magistratë e jo magistratë me temë "Sistemi disiplinor në një këndvështrim të përgjithshëm". Trajnimi u organizua në bashkëpunim me misionin EURALIUS V, me përfaqësues drejtuesen e projektit Dr. Agnes Bernhard dhe ekspertin ndërkombëtar zj. Anita Mihailova.

Në fjalën e tij Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani foli për punën e zyrës së ILD-së gjatë këtij viti të parë, në drejtim të zbatimit të kuadrit të ri ligjor mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë si dhe trajtimin e ankesave që vijnë nga qytetarë dhe institucione.

Pjesëmarrësit në trajnim diskutuan edhe mbi përputhshmërinë e sistemit të ri disiplinor të Shqipërisë me praktikën e standardet ndërkombëtare.

Ky është i pari nga një cikël trajnimesh që zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvillon në bashkëpunim me misionin EURALIUS V në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe do përfshijë edhe ndihmës inspektorët dhe kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

TAIEX DHE ILD TRAJNIM MBI ÇËSHTJET DISIPLINORE TË MAGJISTRATËVE



Një trajnim online u zhvillua me stafin e ILD-së, Inspektorë, ndihmës inspektorë, këshilltarë ligjorë e drejtorë juridikë nga misioni i ekspertëve të Bashkimit Evropian TAIEX me fokus çështjet disiplinore të magistratëve. Qëllimi i trajnimit ishte marrja e dijeve të thelluara mbi zbatimin e legjislacionit në shtete të caktuara të Bash-

kimit Evropian, e posaçërisht në një vend si Spanja, mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve të autorizuara për të kryer hetimet dhe procedimet disiplinore ndaj magistratëve, çështjet disiplinore të magistratëve (gjyqtarëve dhe prokurorëve), metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare për hetimin dhe procedimin disiplinor nga institucionet e këtij shteti, përputhshmëria me kuadrin ligjor të BE-së dhe jurisprudenca mbi shkeljet disiplinore të magistratëve.

Trajnues ishin anëtarë të spikatur të Këshillit të Përgjithshëm të shërbimit të Inspektimit të Gjyqësorit dhe zyra e Prokurorisë së Përgjithshme të Spanjës.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani, mirëpret inspektorët e rinj

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani priti në fillim të muajit Shkurt 8 Inspektorë të rinj, që bëhen pjesë e stafit të zyrës së ILD-së.

Janë 4 Inspektorë magistratë-prokurorë të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe 4 Inspektorë jo magistratë, pjesë e procesit të rekrutimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që i bashkohen të vetmes Inspektore magistratë, që ILD ka patur gjatë këtij viti të parë të ekzistencës së vet.

Gjatë bashkëbisedimit me Inspektorët e rinj, z. Metani shprehu kënaqësinë, që ekipi i Inspektorëve nis të plotësohet, një domosdoshmëri kjo, nisur edhe nga numri i lartë i ankesave të marra gjatë këtij viti ndaj prokurorëve e gjyqtarëve, por edhe të trashëguara nga institucionet e tjera.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Metani nënvizoi nevojën që Zyra e ILD-së, të ketë në përbërje edhe Inspektorë magistratë gjyqtarë, si pjesë e procesit të punës por edhe balancës mes inspektorëve magistratë me ata jo magistratë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë intervistë në Vizion Plus

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani, dha një intervistë për TV Vizion Plus me gazetaren Pranvera Borakaj.

Gjatë intervistës Inspektori përshëndeti aksionin e SPAK në gjykatën e Krugës dhe theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi midis institucioneve të reja të drejtësisë. Ndër të tjera Z. Metani bëri një analizë të sistemit të drejtësisë duke evidencuar dy anët e tij: nga njëra anë drejtësia e vjetër, që refuzon në mënyrë aktive t'i nënshtrohet ligjit dhe drejtësia e re, e cila po punon në mënyrë konsekuente në zbatimin e detyrimeve të veta ligjore.

Sipas Z. Metani, kjo është një "luftë", një proces që do dojë kohën e vet, e për të cilën, nuk ka rëndësi nëse verdiktin final e jep ILD, SPAK, KLGJ apo KLP. Për Inspektoren e Lartë të Drejtësisë me rëndësi është të kuptohet se drejtësia arrihet kur jemi të gjithë bashkë, të gjithë bashkë për një qëllim. E për atë qëllim, mendja e zemra duhet të punojnë si një muskul i vetëm, në mënyrë që interesat e shenjta të drejtësisë të ruhen të pastra.

INSPEKTORI I LARTË METANI: KJO ËSHTË NJË LUFTË MES DREJTËSISË SË VJETËR DHE TË RE PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Pjesë nga Intervista në Vizion Plus:

Gazetarja Pranvera Borakaj: Cili është mesazhi që i përcjell ky reagim institucioneve të reja të drejtësisë?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Mesazhi është që për sa kohë do respektohet parimi i shenjtë i ndarjes së pushteteve dhe bindjes së brendshme të magistratit, pavarësisë së gjyqtarit e prokurorit në vendimmarrjet e veta, po aq i rëndësishëm është edhe mesazhi që çdo veprim i paligjshëm është në monitorim nga institucionet e reja të drejtësisë dhe nuk do shkojë pa u ndëshkuar.

Gazetarja Pranvera Borakaj: Ju thatë pak më parë, në fillim të kësaj interviste se ka një ndarje mes drejtësisë së vjetër dhe drejtësisë së re. Ka emra të tjerë prokurorësh apo gjyqtarësh të cilët mund të jenë të arrestuar apo të akuzuar ditën e nesërme, pra flas në të ardhmen, që janë nën hetim?



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Po e kuptoj. Puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është një punë disa mujore, por është një punë në vazhdimësi dhe raste e ankesa paraqiten në çdo kohë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është duke i verifikuar me shumë kujdes dhe në rastin e parë që do paraqitet një shkelje e kryer nga një magistrat i caktuar do i drejtohem Këshillit përkatës për vendimmarrjet e tyre.

[Kliko](#) për të ndjekur intervistën e plotë.


Nënskruhet memorandum mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani dhe Prokurori i Përgjithshëm Olsian Çela formalizuan sot përmes nënskrimit të një memorandumit, bashkëpunimin ndërinstitutional në drejtim të inspektimeve tematike e shkeljeve individuale të magistratëve prokurorë.

Metani dhe Çela u shprehën se procedimi disiplinor duhet t'i shërbejë llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magistratëve prokurorë, në një ekuilibër

midis primeve të interesit publik për administrimin e drejtësisë, respektimit të të drejtave të individëve, parimit të ligjshmërisë, gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, si dhe atij të ndarjes së pushteteve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm e vunë theksin tek vendosmëria për respektimin rigoroz të Kushtetutës dhe ligjeve gjatë proceseve respektive të punës së dy institucioneve.



ARTUR METANI: ILD PO MONITORON LIRIMET PARA KOHE ME KUSHT

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani bashkëbisedoi me gazetarin Eni Ferhati në Euronews Albania mbi ndalimin nga SPAK të një magjistratë në procedim disiplinor nga ILD dhe raste të tjera në verifikim e hetim.

Gazetari Eni Ferhati: Zoti Metani fillimisht cili është komenti juaj për arrestimin e gjyqtarës së Krujës Enkelejda Hoxha, për të cilën në fakt ju i kishit kërkuar më herët Këshillit të

Lartë Gjyqësor shkarkimin e saj nga detyra?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Së pari unë dua të falenderoj e përgëzoj punën e SPAK-ut për arritjen e djeshme në luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Ky është një fakt që tregon se institucionet e reja të drejtësisë po funksionojnë, natyrisht jo me efikasitetin e vet të plotë dhe jo në pritshmëritë e publikut, por



“Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të jetë çekan mbi kokat e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të prekur pavarësinë e tyre, por nuk ka shans më, që shkeljet e tyre ligjore të shkojnë pa u ndëshkuar. Secili të bëjë llogaritë e veta tani”.

duhet t'i japim kohën ngritjes së institucioneve, krijimit të praktikave të para, punëve të para, arritjeve të para, në mënyrë që efikasiteti i reformës të bëhet i dukshëm sa më shpejt të jetë e mundur.

Gazetari Eni Ferhati: Po nga puna e deritanishme, kush rezulton se kanë abuzuar më shumë me detyrën prokurorët apo gjyqtarët dhe për kë kategori ka më shumë ankesa?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Në



përgjithësi ka më shumë ankesa për gjyqtarët sepse duke qenë edhe organi fundor vendimmarrës sigurisht është ndoshta më pranë ndjeshmërive së publikut, kënaqësive apo pakënaqësive të tij për këtë vendim-marrje. Natyrisht që ka ankesa edhe për prokurorë por numri më i madh i ankesave vjen për gjyqtarët.

Gazetari Eni Ferhati: Për ta mbyllur cili është mesazhi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për sistemin?


Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Zbatimi i reformës në drejtësi tashmë me paligjshmëritë në sistem është luftë e të gjitha institucioneve të reja të drejtësisë. Për këtë arsye mendoj, se mënyra më e mirë për ta fituar këtë luftë është bashkëpunimi midis institucioneve të reja të drejtësisë. Prandaj unë përgëzoja punën e SPAK-ut dhe thashë që secili në punën e vet dhe në kufijtë e vet të kompetencave po ecën me zbatimin e reformës në drejtësi.

[Klikoni](#) për të ndjekur intervistën e plotë.

Shkurt 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", godina nr.13
Sheshi "Nënë Tereza"



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani](#)
[@ILD_Albania](#)



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë](#)